



**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°7/2021

Hagë, 28/10/2021

Përditësim

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'ju ofrojmë një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë si dhe informacion për javën e ardhshme.

Ditën e hënë dhe të martë të kësaj jave Mbrojtja vazhdoi me pyetjet e veta drejtuar dëshmitares së parë, e cila është hetuese e ZPS-së, në çështjen e Hysni Gucati dhe Nasim Haradinajt. Dëshmitarja dëshmoi lidhur me sekuestrimin e dokumenteve që kreu ZPS-ja nga Organizata e Veteranëve të Luftës të UÇK-së shtatorin e vitit të shkuar dhe nëse në to gjendej informacion që konsiderohej konfidencial nga ZPS-ja.

Trupi Gjykues bëri të ditur se do të marrë mendimet e Mbrojtjes dhe të Prokurorisë lidhur me disa nga provat e dhëna nga dëshmitarja e parë gjatë dëshmisë së saj. Mbështetur në këto parashtrime, gjykatësit do të vendosin nëse do të lejojnë që këto prova të merren parasysh në gjykim.

Të martën pasdite, filloi me dhënien e dëshmisë dëshmitari i dytë, një gazetar nga Kosova. Dëshmitari është detyruar të paraqitet në përputhje me rregullën 121(2) të Rregullores së Procedurave dhe Provave dhe ndihmohet prej një avokati. Dëshmitari dëshmoi mbi mënyrën sesi ai dhe redaksia e tij e lajmeve i morën dokumentet nga Organizata e Veteranëve të Luftës të UÇK-së.

Dëshmitari i tretë në këtë çështje ka filluar dëshminë e tij sot.

Gjithashtu, lidhur me çështjen *Gucati dhe Haradinaj*, Trupi Gjykues i drejtoi një urdhër policisë së Kosovës ku i kërkon që deri më 26 nëntor të paraqesë informacion lidhur me kompetencat dhe mundësitë e tyre në rast se do të miratohej lirimi i përkohshëm i z. Gucati dhe z. Haradinaj.

Në vendimin përkatës, Gjykatësi i ka drejtuar urdhër Administratores që të paraqesë informacion me shkrim, brenda të njëjtit afat, lidhur me rregullat konkrete që zbatohen në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, në veçanti sa u





**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°7/2021

Hagë, 28/10/2021

takon kufizimeve të mundshme në lidhje me vizitat dhe komunikimin e të paraburgosurve.

Në çështjen gjyqësore *Hashim Thaçi dhe të bashkakuzuarit e tjerë*, të mërkurën Paneli i Gjykatës së Apelit rrëzoi Apelin e z. Thaçi kundër Vendimit të Gjykatës të Procedurës Paraprake mbi Rishikimin e Paraburgimit.

Ndër të tjera, Paneli i Gjykatës së Apelit u pajtua me vlerësimin e Gjykatës të Procedurës Paraprake se ekziston ende rreziku i pengimit të ecurisë së proceseve gjyqësore të DHS-së dhe konstatoi se Mbrojtja nuk arriti të demonstronte se Gjykatësi i Procedurës Paraprake kishte gabuar në vlerësimin e tij lidhur me kushtet e lirit. Vendimi është botuar në faqen zyrtare të DHS-së.

Konferenca e ardhshme për ecurinë e çështjes gjyqësore konkrete është planifikuar për nesër (të premtën) në orën 2:30 të pasdites. Disa nga pikat në rendin e ditës janë nxjerrja e materialeve dhe hapat hetimore.

Në lidhje me aktivitetet e javës së ardhshme, ditën e martë, 2 nëntor do të rifillojë gjykimi i Salih Mustafës ku do të japë dëshminë dëshmitari i pestë.

Ndër lajmet e tjera: këtë javë ekipi i Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim i Dhomave të Specializuara të Kosovës mbajti diskutime me banorët nga komunitetet pranë Kamenicës dhe Pejës, të cilëve u dha informacion bazë mbi Gjykatën dhe procedurat e saj si dhe iu përgjigj pyetjeve. Takimet u mbajtën përmes internetit.

Që prej vitit 2008, Dhomat e Specializuara kanë organizuar aktivitete të ngjashme ndërgjegjësuese në gjithë Kosovën me qytetarët e saj, të rinjtë, shoqërinë civile, etj., për t'u dhënë informacion rreth Gjykatës, për të dëgjuar komentet dhe shqetësimet e pjesëmarrësve si dhe për t'u përgjigjur pyetjeve.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

